



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 1346/prot.
4

Tiranë më 3.10.2018

VENDIM

Nr. 47, datë 3.10.2018

PËR KONTROLLUESIN "BAR KAFE JURGEN"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "BAR KAFE JURGEN" (*Emri i subjektit "Edmond Brusha", Nipt L31412009A*).

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 210, datë 10.09.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "BAR KAFE JURGEN" me objekt:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një qytetar dhe ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "BAR KAFE JURGEN", konstaton se:

1. Kontrolluesi në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë ka instaluar një sistem kamerash CCTV, i përbërë nga 8 kamera. Njëra nga kamerat rezultonte e pozicionuar dhe fokusuar në fasadën e pallatit, ku ndodhen dritaret e kateve sipër ambienteve të kontrolluesit.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se fokusimi i kamerës në ambientet e banorëve të pallatit dhe monitorimi i tyre cënon privatësinë e tyre dhe është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë, parashikuar në nenin 5/1/c të Ligjit nr. 9887,

datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.3, datë 05/03/2010 mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video- survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar. Në këtë rast, tejkaloheq qëllimi i përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të CCTV, që është siguria e ambienteve të kontrolluesit. Qëllimi i sigurisë duhet të realizohet pa cënuar privatësinë e banorëve të pallatit.

Referuar provave të administruara nga grupi i hetimit administrativ sa i përket fotove të pamjeve të sistemit të kamerave CCTV dhe të ambienteve të mbikëqyrura, rezulton që pretendimet e palës ankuese qëndrojnë dhe janë të bazuara.

Në bazë të Udhëzimit nr.3, datë 05/03/2010 mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar kamerat duhet të konsiderohen si mjete i fundit për të realizuar qëllimin (sigurinë).

2. Në ambientet e kontrolluesit nuk ishin vendosur tabelat e informimit të subjekteve të të dhënave personale (qytetarë, klientë) mbi vendosjen e sistemit të kamerave, sipas standartit të miratuar me Udhëzimin nr. 3, datë 05/03/2010 mbi “Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar. Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave është një detyrim ligjor mjaft i rëndësishëm për kontrolluesit (referuar nenit 18 të ligjit nr. 9887) pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të ushtrojnë të drejtat ligjore që gëzojnë në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend grupi i inspektimit hartoi procesverbalin (datë 18.09.2018), të cilin përfaqësuesi i kontrolluesit z. Edmond Brusha e ka marrë në dorëzim por nuk pranoi ta nënshkruajë. Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit, në datën 02.10.2018, ishte caktuar seanca dëgjimore, ku përfaqësuesi i kontrolluesit refuzoi të merrte në dorëzim njoftimin për të. *(flesa për seancën dëgjimore është kthyer 2 herë nga posta dhe është administruar në cilësinë e provës në dosje).*

Si përfundim, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 gërma “a”, të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë, si më poshtë:

a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale që përpunohen nëpërmjet sistemit të CCTV, në kuadër të impaktit që ka, pasojat që sjell dhe rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimit të ligjshëm

të të dhënave, si dhe të drejtën e subjekteve të të dhënave për t'u informuar mbi përpunimin e të dhënave të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5/1/c, 29, 30, 31, 32, 39/1/a, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Bar Kafe Jurgen" me gjobë, në vlerën **50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në 5/1/c të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Kontrolluesi "Bar Kafe Jurgen", të bllokojë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale të siguruara nga kamera e pozicionuar dhe fokusuar në fasadën e pallatit.
3. Kontrolluesi "Bar Kafe Jurgen", të shkatërrojë të dhënat e siguruara nga kamera e pozicionuar dhe fokusuar në fasadën e pallatit.
4. Kontrolluesi "Bar Kafe Jurgen", të ndryshojë pozicionin e kamerës të fokusuar në fasadën e pallatit.
5. Kontrolluesi "Bar Kafe Jurgen", në të gjitha ambientet të vendosë, në pozicion lehtësisht të dukshëm, tabelat informuese të sistemit të kamerave, sipas standartit të miratuar me Udhëzimin nr. 3, datë 05/03/2010 mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar.
6. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 3.10.2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

